



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Për shkak të largimit vullnetar të një anëtareje të **Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile** në linjë me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.02.2019 për aprovimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 02/04/2019 Nr.05/96, mbi themelimin e **Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile**, Platforma Civikos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, hap thirrjen për:

- Një përfaqësues të **Rrjeteve Tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile** që veprojnë në Kosovë për Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile Qeveri 2019-2023.

KRITERET PËR NOMINIM

Rrjetet tematike duhet ti plotësojnë këto kritere:

- Të jenë aktiv si rrjet i organizatave në një fushë të caktuar me më së paku 10 organizata anëtare;
- Përvojë të dëshmuar të funksionimit të rrjetit për së paku tri vitet e fundit ;
- Të dëshmojnë angazhimin e tyre dhe/ose organizatave anëtare në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KËTO KUSHTE

- Përvojë së paku tri vite në organizatë ose rrjet;
- Përkushtim në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR NOMINIM (RRJETET TEMATIKE)

Rrjetet tematike të OSHC-ve duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së rrjetit, ku dëshmon veprimtarinë e rrjetit për tri vitet e fundit (max 1 faqe a4)
- Statutin dhe certifikatën e regjistrimit të OJQ-së (nëse është rrjet i regjistruar).
- Listën e organizatave anëtarëve me kontakte.
- CV- në e kandidatit/es që rrjeti e nominon si përfaqësues/e të tyre.

KUFIZIMET NË PROCESIN E NOMINIMEVE

- Rrjeti tematik mund të nominoj vetëm një kandidate/t.

ANGAZHIMI NË KËSHILL ËSHTË PA KOMPENZIM FINANCIAR

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE PROCEDURA E VOTIMIT

Rrjetet tematike të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar duhet të plotësojnë kriteret bazë, siç janë të përcaktuara në thirrje.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos-it dhe një përfaqësues i Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyres së Kryeministrit (ZQM/ZKM) do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos, dhe ZQM do të njoftojnë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojnë në faqen e tyre të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OJQ-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit.

Secila organizatë mund të votojë për 1 kandidate/t.

Te drejte vote kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në Kosovë.

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt, ose personalisht në zyrën e CiviKos. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos-it.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos, dhe përfaqësues të ZQM. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. 4 përfaqësuesit e rrjeteve tematike dhe 10 përfaqësuesit e OJQ-ve që marrin më së shumt vota përzgjidhen si anëtarë të Këshillit. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve të gjitha OJQ-të-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe të interesuar të tjerë

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar.

Afati për nominim është nga 28.06.2022 deri më 04.07.2022 ora 16:00

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit info@civikos.net ose numrit të telefonit 038 224 904.